



VLERA E NAMAZIT
TË TERAVISË



RAMAZANI
ËSHTË MUAJ I XHEMATIT



RAMAZANI,
SI MUAJ I KUR'ANIT

Viti XV - Nr. 5 (171),
Maj, 2017

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

KY MUAJ ËSHTË MUAJ I PAQES, I QETËSISË SHPIRTËRORE!



PËRKUSHTIMI, SI BOSHT ESENCIAL NË JETËN E AQJËRUESIT

Qëllimi i Ramazanit nuk është thjesht agjërimi, apo siç e tregojmë rëndomtë, qëndrimi pa ngrënë dhe pa pirë, nga para lindjes së diellit, deri në perëndimin e tij. Nëse ndalemi dhe meditojmë në ajetin Kur'anor, ku Allahu (xh.sh) na thotë shprehimisht: “O ju që keni besuar, agjërimi ju është bërë obligim, siç ka qenë obligim edhe për ata që kanë qenë përpara jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm.” (Bekare: 183)

Do të vëmë re, se qëllimi i agjëritit të Ramazanit është arritja e devotshmërisë, apo e përkushtimit, duke na bërë të ditur, se largimi nga ngrënia dhe nga pija është vetëm një aspekt i agjëritit.



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Zotit të Vetëm të gjithësisë, Atij që na krijoi nga asgjëja dhe na bëri të shkelim në tokën e Tij, na dhuroi prej mirësive të panumërta, na krijoi mundësinë të hedhim vështrimet përreth, të dallojmë të mirën nga e keqja, pasi na e sqaroi secilën prej tyre nëpërmjet Kur'anit Famëlartë dhe Traditave të shumta të Hz. Muhamedit (a.s)!

Në këtë jetë kalimtare, All-llahu i Madhëruar nuk e la njeriun vetëm. Me qindra mijëra të dërguar nga ana e Tij, për ta udhëzuar rrugëtimin e njeriut në këtë botë kalimtare. Shumë shpallje e Libra të shenjtë, që njeriu mos të devijonte rrugën..., ndërkohë sot, në vitin 2017, fatkeqësisht njerëzimi e bota ndodhen në gremina të frikshme të dekadencës morale, shpirtërore, intelektuale e përtej!

Atij i qofshim falë që e bëri Muajin e Madhërishtë të Ramazanit, një mundësi të përvitshme ndryshimi, sistemimi, rregullimi e ndreqjeje të marrëdhënies me veten, me Madhërinë e Tij, me botën dhe krejt krijesat përreth nesh!

TË DASHUR DHE TË NDERUAR VËLLEZËR E MOTRA, BESIMTARË,

Po të lexojmë me vëmendje kurbën e ajeteve të shpallura në hak të agjërit të Ramazanit, do të gjejmë një dukuri të mrekullueshme, që lidhet drejtpërsëdrejti me mundësitë që na afron Muaj Ramazan drejt afrimit dhe përfuturit nga Mëshira dhe Begatitë e shumta që shpërndahen për besimtarët e përkushtuar, rrugëtues drejt perfeksionimit të konceptit të përkushtimit (takvasë) në jetë, gjatë këtij Muaji.

Dëgjoni me vëmendje, ju dëgjoftë zemra dhe shpirti:

KY MUAJ ËSHTË MUAJ I PAQES, I QETËSISË SHPIRTËRORE!

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm” - (El-Bekare: 183)

AJETI 183:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”¹ – (Prezantimi me dispozitën e agjërit dhe shpallja botërisht se ai është një adhuring i njohur në historinë e njerëzimit, nga krejt popujt e shkuar).

FILLIMI I AJETIT 184:

“(Jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmure prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju....”² – (Toleranca dhe lehtësimi për krejt grupet e njerëzve me justifikime objektive, të sqaruara në ajet, si udhëtarët, sidomos në rrugëtime të gjata e të lodhshme, të sëmuret e pamundur etj.).

FILLIMI I AJETIT 185:

“Muaji i Ramazanit, është ai, në të cilin nisi të shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz, sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria)...”³ – (Fokusimi tek shpallja e Kur’anit, si një stacion që duhet marrë në konsideratë gjatë gjithë jetës, por veçanërisht në Ramazan. Ky Kur’an, për të cilin thotë në Librin e Tij: “Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi ndonjë mal, do ta shihje atë të struktur e të çarë prej frikës nga All-llahu...”⁴).

FILLIMI I AJETIT 186:

“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua!”⁵ – (Shpallja botërisht e komunikimit pa ndërmjetës, nëpërmjet lutjes, që është arma më e fuqishme e çdo njeriu, pa

dallim feje, race, kombësie, përkatësie!)

Pra, të dashurit e mi, vetëm duke vështuar sipërfaqësisht në këto katër ajete, lexojmë qartas hartën e begatë të Ramazanit, që nis me agjërimin e plotë të tij, na përkujton tolerancën dhe lehtësimin, si parim jete për muslimanin, ndalet tek Kur’ani Famëlartë, si udhërrëfyes i patjetërsueshëm në jetë, si dhe pushon tek lutja, si vendtubimi i krejt atyre, që besojnë tek Zoti i gjithësisë.

Të dashur e të nderuar të pranishëm,

Nga ky minber, i dërgojmë salavatet dhe selamet më të përzemërta, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhamedit (a.s), të dërguarit mëshirë për krejt tanësinë.

**Atij i qofshim falë
QË E BËRI MUAJIN
E MADHËRISHËM TË RAMAZANIT,
NJË MUNDËSI TË PËRVITSHME
NDRYSHIMI, SISTEMIMI,
RREGULLIMI E NDREQJEJE
TË MARRËDHËNIES ME VETEN,
ME MADHËRINË E TIJ,
ME BOTËN DHE KREJT KRIJESAT
PËRRETH NESH!**

Zotëria i jonë (a.s) thoshte: “Kur vjen Ramazani hapen dyert e xhennetit, mbyllen dyert e xhehneimit dhe lidhen shejtanët”⁶, si për të na shpjeguar se ky muaj është Muaj i Paqes, i qetësisë shpirtërore, i atmosferës më të bekuar të krejt vitit, si dhe një Muaj, ku gjithësia është në shërbim të besimtarit; e mira zbret nga qielli, toka mbushet me bekim dhe influenza e të mallkuarit nëpërmjet cytjeve të tij është inekzistente.

Mirëpo, në këtë kontekst ka disa dilema, që dua të sqaroj:

6. Transmetuar nga Nesiau.

1. Kur’ani, El-Bekare: 183.
2. Kur’ani, El-Bekare: 184.
3. Kur’ani, El-Bekare: 185.
4. Kur’ani, El-Hashr: 21.
5. Kur’ani, El-Bekare: 186.

Sepse shenjtëritë janë më të denja për t’u respektuar dhe nderuar, se krejt zgjedhjet e botës, sikurse Festat tona fetare janë të shenjta dhe pjesë solide e boshtit tonë kombëtar, prekja e të cilit duhet të jetë për këdo e kurdo, kufi i ndaluar!

HAPJA E DYERVE TË XHENNETIT DHE MBYLLJA E DYERVE TË XHEHNEMIT:

Transmetohet se: “Sikur ta dinin njerëzit mirësinë e Ramazanit, do të dëshironin ymmeti im që krejt viti të ishte Ramazan. Dhe, sikur t’ia lejonte Zoti qiejve dhe tokës të flisnin, ato do të dëshmonin xhennetin për ata që agjërojnë Ramazanin!”⁷

Pra, gjithësia është e angazhuar për të dëshmuar vlerat e këtij muaj, përsosmëria e të cilit shpie drejt xhennetit dhe e mbron të zotin nga ndëshkimi i ditës së gjykimit!

Poashtu, transmetohet se Resulull-llahu (a.s), ka thënë: “Pesë namazet ditore, nga e xhumaja në të xhuma dhe nga Ramazani në Ramazan, bëhen shkak për faljen e gjynaheve në mes tyre, nëse njeriu largohet nga gjynahet e mëdha!”⁸, që do të thotë edhe se, Ramazani është një stinë e begatë faljeje, mëshire dhe bekimi, që shpie në xhennet dhe largon nga ndëshkimi i xhehneimit!

LIDHJA E SHEJTANËVE:

Ka sot, kanale televizive, rrjete sociale e publikime të shkruara, që e nxjerrin shejtanin në pension! Sikurse ka edhe njerëz të pakursyer në misionin e tyre, që punojnë ditë-natë kundër besimit dhe besimtarëve, kundër fesë së All-llahut dhe Dritës së saj.

Sa herë jemi ngushtuar vitet që kaluan nga koncertet e zhurmshme, “festat” rinore e ato të pijeve të haramit, që janë zhvilluar para Bashkisë, pak metra larg xhamisë së Parrucës a para xhamisë “Ebu Bekër”?! Nuk i duam këto tubime para dyerve të shtëpive tona dhe xhamive të muslimanëve! Duam që institucionet tona të respektojnë tabanin e besimit dhe qytetarisë së muslimanëve dhe të mos bëjnë veshin shurdh, sa herë kërkojmë legjitimisht respektimin e simbolikave të fesë dhe identitetit tone!

7. Imam El-Ebshihi, “El-Mustatraf”, Bejrut 1981, f. 39.
8. Transmetuar nga Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

Sa herë e kemi ngritur zërin tek institucionet tona, tek biznesi, politika etj., që të respektohet Ramazani, të respektohet feja e Zotit dhe shenjtëria e tij, por jo përherë kemi marrë përgjigjen e prituri?!

Sa jemi befasuar, kur dëgjuam dy aktorët kryesorë të politikës së sotme shqiptare, që caktuan si datë të zgjedhjeve të sivjetshme, ditën e Fitër Bajramit, një fenomen që besoj se as në kohën e errët të sistemit ateo-komunist nuk mund të ketë ndodhur, edhe pse asokohe feja ishte e ndaluar me ligj!?

(Natyrshtëm, për këtë të fundit, ne do të presim reagimin zyrtar të Komunitetit tonë, porse, në mënyrë kategorike, e refuzojmë që dikush të prekë, me sado neglizhencë të paqëllimtë, harresë të imponuar nga presione të lodhshme a pakujdes ndaj shenjtërive të 70% të popullit shqiptar, por edhe të qoftë 1% të tij, sepse shenjtëritë janë më të denja për t’u respektuar dhe nderuar, se krejt zgjedhjet e botës, sikurse Festat tona fetare janë të shenjta dhe pjesë solide e boshtit tonë kombëtar, prekja e të cilit duhet të jetë për këdo e kurdo, kufi i ndaluar!)

Pra, të dashurit e mi, lidhja e shejtanëve, duhet kuptuar si një mundësi që na jepet për të kontrolluar veten e për ta vendosur atë në peshoren e besimit, për të parë me sy të lirë sesa jemi ndikuar nga e keqja dhe jemi bërë pjesë e saj gjatë 11 muajve të shkuar dhe sa jemi në gjendje ta mposhtim atë, duke rrugëtuar agjërueshëm drejt dyerve të lehtësimit e tolerancës, Kur’anit dhe lutjes!

Qoftë i mbarë dhe plot bekim për krejt ju, ky Muaj!

Bekimet dhe mëshira e All-llahut u përhapshin si pelerinë Paqeje mbi Shkodër, Shqipëri, mbi ymmetin islam e mbarë njerëzinë! Amin!

(Hytbeja e mbajtur më 19 maj 2017 në xhaminë e Parucës, në prag të Ramazanit 1438/2017)



PEJGAMBERI (A.S)

KA THËNË:

“Agjërimi është

i Allahut (xh.sh)

dhe askush

nuk e di

shpërblimin

E AGJËRUESIT, PËRVEÇ

Allahu (xh.sh).”

(Transmetuar nga Tabaraniu)



Naim Driaj

Imam, xhamia Parrucë

NATA E 15-TË E MUAJIT SHABAN

do ta jepje atë për të shpëtuar veten nga ky vend. PO përgjigjet robi. Atëherë Allahu i madhëruar i thotë: Kam kërkuar prej teje më pak se sa kaq që të mos më përshkruash shok e Unë të të mos të fus në Xhehennem por ti ke refuzuar dhe më ke përshkruar shok.”³

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Bëni kujdes, shmanguni nga shtatë gjynahet shkatërruese. Cilat janë ato, o i Dërguari i Allahut? e pyetën. Ai tha: një ndër to është: T’i bësh shok Zotit...”⁴

2) Pastërtia e zemrës dhe e raporteve me krijesat. Në muajin Shaban nga ne kërkohet rregullimi i raporteve me njerëzit ndërsa muaji i Ramazanit është muaji ku bëhet kultivimi i këtyre raporteve. Në muajin Shaban besimtarët e pastrojnë zemrën e tyre prej dukurive negative siç janë: smira, urrejtja... etj, ndërsa në muajin e Ramazanit e ushtrojnë atë që të jetë e fortë karshi provokimeve. Profeti (a.s) na ka mësuar që në raste provokimesh njerëzve t’u themi: “Unë jam agjërueshëm!”⁵

3) Mëshira e madhe e Allahut të Lartësuar. Prej mirësisë të shumta të Allahut është, që për robërit e Tij ka caktuar kohë të shumta për faljen e gjynaheve, një prej të cilave është edhe kjo natë. Mësimet që dalin nga ky hadith janë mësimet të cilat vlejshëm çdoherë, në çdo kohë dhe për çdo njeri.

Ky është një rast i volitshëm për çdo gjynahqarë që është neglizhent ndaj hakut të Allahut të reflektoj, është një rast i mirë për tu pastruar nga zilia, mosmarrëveshjet, grindjet, urrejtja, smira që ekziston në mes besimtarëve, për tu çliruar nga prangat e këtyre veseve njëherë e përgjithmonë duke e bërë moto fjalën e Zotit.

Allahut (xh.sh) thotë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve!”⁶

Muaji Shaban llogaritet si muaji që bën përmbylljen vjetore të veprave të njeriut. Mes vlerave të këtij muajit përmendim faktin se në këtë muaj veprat e njeriut ngritën (paraqiten) tek Allahu (xh.sh). Usume bin Zejd (r.a) transmeton e thotë: “I thashë profetit: O i Dërguar i Allahut, nuk të kam parë të agjërosh ndonjë muaj tjetër (përveç Ramazanit) më shumë se sa muajin Shaban? Ai tha: Ai është një muaj mes Rexhebit dhe Ramazanit. Njerëzit tregohen të pakujdesshëm në këtë muaj, megjithëse ai është muaji në të cilin ngritën veprat tek Allahu (xh.sh) Prandaj unë kam dëshirë që veprat e mia të ngritën (paraqiten) tek Zoti ndërsa unë jam agjërueshëm.”⁷

NGA KY HADITH NXJERRIM KËTO MËSIMET:

1) Muaji Sha’ban është muaji në të cilin ngritën veprat tek Allahu, pra bëhet përmbyllja vjetore e tyre. Kjo i bie që Ramazani është fillimi i vitit të veprave.

2) Fakti që muaji Sha’ban shënon fundin e vitit të veprave, besimtarin e bën që të rishikojë gjendjen e tij, të pendohet dhe të përmirësojë gabimet. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Të gjithë bijtë e Ademit (a.s) janë gjynahqarë më i miri prej tyre është ai i cili pendohet.”⁸

3) Agjërimi në muajin Shaban është parapërgatitje dhe ushtrim i besimtarit

6. Kur’ani, El-Hashr, 10.
7. Ahmed, Nesai, nr. 2356.
8. Tirmidhiu, ibn Maxheh dhe Hakimi.

1. Ibn Maxheh, nr. 1140.
2. Kur’ani, En-Nisa: 48.

3. Buhariu, Muslimi.
4. Buhariu.
5. Buhariu, Muslimi.

“ALLAHU I LARTËSUAR NË NATËN E 15-TË TË MUAJIT SHABAN UA FALË GJYNAHET TË GJITHË KRIJESAVE TË TIJ, PËRVEÇ ATYRE QË I BËJNË SHOK ATIJ DHE ATYRE QË JANË TË HIDHËRUAR ME NJËRI-TJETRIN.”



për të qenë i gatshëm për obligimin e madh, për njërën nga pesë shtyllat bazë të Islamit që është agjërimi i ramazanit.

4) Njeriu duhet të mundohet që punët vullnetare (nafle) t’i kryej sipas mundësive që ka, pa e munduar veten tej mase duke u larguar kështu tërësisht prej adhurimit. Ky është shkaku pse Pejgamberi (a.s) kishte raste që agjëronte aq shumë sa që njerëzit mendonin se ai kishte vendosur të mos hante më ushqim, por kishte edhe raste të tjera kur nuk agjëronte për një kohë aq të gjatë, sa që njerëzit mendonin se ka vendosur të mos agjërojë më nafle.

Aishja (r.anha) thotë: «Pejgamberi (a.s) agjëronte aq shumë sa njerëzit mendonin se ka vendosur të mos hante më, dhe nuk agjëronte një kohë aq të gjatë sa që njerëzit mendonin se nuk do të agjërojë më nafle. Nuk e kam parë Pejgamberin (a.s) të agjërojë një muaj të tërë përveç Ramazanit, ndërsa më shpesh e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban».⁹

5) Dijetarët Islam për të treguar vlerën e agjëritimit në këtë muaj kanë thënë se: Veprat më të mira vullnetare janë ato të cilat kryhen sa më afër muajt të Ramazanit, qofshin ato pak para tij apo pas tij. E njëjta gjë vlen edhe me agjërimin e Ramazanit. Agjërimi më afër tij konsiderohet si sunetet e forta të namazit që falen para ose pas farzit, të cilat plotësojnë mangësitë dhe lëshimet që mund të kenë ndodhur në farz.

6) I Dërguari i Allahut (a.s) na ka mësuar që të agjërojmë para muajit të ramazanit po ashtu edhe pas tij. Agjërimi që bëhet para ramazanit është në muajin shaban dhe pas ramazanit janë 6 ditët e muajit Shevval.

Ebu Ejub El-Ensari (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush e agjëron muajin e Ramazanit, pastaj e përcjell me agjërimin e gjashtë ditëve të Shevvalit, ka shpërblimin sikur të kishte agjëruar tërë vitin.”¹⁰

7) Nxijtja për ibadet në kohë trazirash dhe kur njerëzit janë neglizhent ndaj Tij. (p.sh) lutja që bëhet kur njeriu hynë në treg, namazi i natës etj.

I Dërguari i Allahut na tregon se adhurimi në kohë trazirash dhe sprovash ka shpërblimin e hixhretit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Adhurimi në kohë trazirash (luftërash) është si të bësh hixhret për tek unë.”¹¹

9. Buhariu dhe Muslimi.
10. Muslimi.
11. Muslimi.

TË JESH AJET NË MIRËSJELLJEN TËNDE..!

“Nëse të vjen një njeri me halle, dëgjoje! Po të erdhi dikush që të kërkon falje, fale! Po të erdhi një nevojtar, jepi!

Prej teje nuk kërkohet të kesh një Mus’haf në xhep, porse të jesh ajet në mirësjelljen tënde!”

I lexova këto rreshta plot urti e thellësi mendimi nga bota e mendimtarit egjiptian, Dr. Mustafa Mahmud dhe më erdhi ndër mend realiteti i mrekullueshëm i sjelljes së Resulull-llahut (a.s), ai i shumë prej sahabëve për të cilët kam lexuar, (e, sa e sa nuk kam lexuar ende), i shtresës së përzgjedhur të njerëzve të mirë në historinë tonë, për të cilët Imam Ibnul-Xheuzi ka një vepër voluminoze me titull: “Cilësitë e të përzgjedhurve”, ku preket transformimi që mësimet e Islamit dhe përkushtimi ndaj tyre i bëjnë njeriut në jetë!

Sa shumë kemi nevojë të përkushtohemi për të arritur në këtë gradë, për t’u lartësuar ne dhe bota e jonë drejt angazhimit të madh ndaj njeriut, faljes, shpenzimit në rrugën e bamirësive, tolerancës në mes

vete, dashamirësisë ndaj çdo krijese, harmonisë në familje, në punë, ruajtjes së lidhjeve farefisnore e përtej tyre.

Nëse Resulull-llahu (a.s) është dërguar mëshirë për mbarë botët, kjo do të thotë se muslimani, teksa përpiqet ta dojë e ta respektojë Traditën e tij (a.s) me shumësinë e mësimëve të saj, është i ftuar të kthehet në mëshirë për familjen e tij, për të afërmit, për shoqërinë e ngushtë, për krejt krijesat dhe mbarë njerëzimin!

A rrugëtojmë ne drejt kësaj vlere dhe këtyre udhëzimeve? Në fakt, Muaji Ramazan, që tashmë po afron, është mundësia më e mirë që na jepet për të kontrolluar veten, për të mbyllur shumë fletë e për të hapur shumë të tjera, duke vështruar me sytë e zemrës nga e nesërmja më e mirë, por mbi të gjitha, duke kërkuar pëlqimin e All-llahut (a.s) për çdo gjë që veprojmë!

Ramazan Mubarek!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 23 maj 2017

**“NËSE TË VJEN NJË NJERI ME HALLE, DËGJOJE!
PO TË ERDHI DIKUSH QË TË KËRKON FALJE, FALË!
PO TË ERDHI NJË NEVOJTAR, JEPË!**

PREJ TEJE NUK KËRKOHET TË KESH NJË MUS’HAF NË XHEP, PORSE TË JESH AJET NË MIRËSJELLJEN TËNDE!”





Lavdrim Hamja
Imam, xhamia e "Dy Vajzave"

Falënderimi i plotë i qoftë Allahut, i Cili ka obliguar ato gjëra, që janë jetike dhe të domosdoshme për jetën njerëzore. Kush i zbaton ato, jeton i lumtur, në paqe shpirtërore dhe ka shpëtuar prej shqetësime e hallevë të dy botëve, ndërsa kush nuk i zbaton obligimet e Zotit të tij, ai askujt nuk i bën dëm, përveç vetes së vet dhe asnjëherë nuk do të gjejë rehati e paqe shpirtërore, madje në botën tjetër do të jetë prej të dëshpëruarve.

Paqja dhe shpëtimi i Zotit të Madhëruar qofshin përmbi mëshirën e mbarë botëve, Pejgamberin (a.s), që na ka mësuar, se përmes agjërimit të Ramazanit, njeriu mund të arrijë kënaqësinë shpirtërore, faljen, mëshirën, pastrimin nga gjynahet dhe shpërblimin e xhenetit, duke na thënë: "Ju erdhi Ramazani muaji i begative të Allahut në të cilin zbrit mëshira, fshihen gjynahet dhe pranohen lutjet. Allahu ju vështroon duke bërë gara me njëri-tjetrin në adhurime dhe mburret me ju te melekët e Tij, prandaj shpalosni prej vetes suaj vepra të mira, sepse i humbur dhe i dëshpëruar është ai njeri, i cili privohet nga mëshira e Allahut në këtë muaj." (Tabaraniu)

Të nderuar vëllezër dhe motra,

Qëllimi i Ramazanit nuk është thjesht agjërimi, apo siç e tregojmë rëndomtë, qëndrimi pa ngrënë dhe pa pirë, nga para lindjes së diellit, deri në perëndimin e tij. Nëse ndalemi dhe meditojmë në ajetin Kur'anor, ku Allahu (xh.sh) na thotë shprehimisht:

"O ju që keni besuar, agjërimi ju është bërë obligim, siç ka qenë obligim edhe për ata që kanë qenë përpara jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm." (Bekare: 183)

Do të vëmë re, se qëllimi i

PËRKUSHTIMI, SI BOSHT ESENCIAL NË JETËN E AGJËRUESIT

"Pejgamberi (a.s) bënte adhurim gjatë muajit të Ramazanit, aq sa nuk bënte ditëve të tjera dhe muajve të tjerë. Ndërsa në dhjetë ditët e fundit (të Ramazanit) bënte adhurim më shumë se ditëve të tjera." - (Muslimi)

agjërimit të Ramazanit është arritja e devotshmërisë, apo e përkushtimit, duke na bërë të ditur, se largimi nga ngrënia dhe nga pija është vetëm një aspekt i agjërimit. Këtë obligim madhështor, të cilin Allahu i Madhëruar, Krijuesi i njeriut dhe i çdo gjëse, ia obligoi të gjithë popujve, nuk ia ka obliguar vetëm për të ndryshuar orarin, apo regjimin e ngrënies dhe pijes, por e obligoi që përmes këtij adhurimi njeriu të lartësohet moralisht dhe të përmirësohet në të gjitha drejtimit, pra të arrijë devotshmërinë e përkushtimin maksimal.

Dikush mund të pyesë se, çfarë është devotshmëria, apo përkushtimi? Në fjalorin e gjuhës arabe do të gjejmë se "takvall-Llahi" (përkushtimi ndaj Allahut) është: "Dashuria dhe frika ndaj Tij, duke zbatuar urdhrat dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij".

Nëse shtojmë këtu edhe hadithin e Pejgamberit (a.s), i cili thotë: "Agjërimi është i Allahut (a.xh) dhe askush nuk e di shpërblimin e agjëruesit, përveç Allahut (a.xh)." (Tabarani – I saktë me transmetime të tjera).

Atëherë, del se përkushtimi gjatë agjërimit të Ramazanit duhet të jetë shumëfish më i madh dhe në formën më të plotë e të më mirë, pasi Zoti e shkroi dhe e obligoi agjërimin e këtij muaji të begatë, që ne bëhemi më të përkushtuar, dhe ky përkushtim nuk do të thotë ndryshe, veçse të kryejmë urdhrat e Tij dhe të largohemi tërësisht prej ndalesave, ndërsa kur mendojmë se këtë agjërim, Allahu ia ka atribuuar Vetes, "Agjërimi është i Imi dhe Unë e shpërblej atë...", duke e marrë si diçka të Tij, nuk ka dyshim se besimtari e ka për nderë ta perfeksionojë këtë punë të Krijuesit të tij. Sikur Zoti i Madh i thotë agjëruesit: Kujdes o rob i Im, sepse ti kur agjëron, je punëtor tek Unë dhe kryeje këtë punë në mënyrën më perfekt dhe njëkohësisht pa përtesë, me kënaqësi të plotë dhe plot dashuri, që të arrish kënaqësinë dhe shpërblimin Tim të pakufishëm.

Të agjërosh me përkushtim dhe

devotshmëri nuk kërkon filozofi të madhe, e as nuk është utopi. Të agjërosh me përkushtim dhe devotshmëri do të thotë: Të tregohesh i matur dhe i kujdesshëm kur flet, kur shikon, kur dëgjon dhe kur vepron. E gjithë kjo maturi kërkohet, sepse siç e përmendëm më lart, nuk është qëllimi të rrimë pa ngrënë dhe pa pirë, sepse nëse agjëruesi nuk largohet prej veseve, fjalëve dhe sjelljeve jokorrekte, atëherë ai nuk e ka përbushur esencën dhe qëllimin e agjërimit. I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë se: "Kush nuk lë fjalët dhe veprat e këqija, Allahu nuk ka nevojë për atë njeri që të lërë ushqimin dhe pijen e tij." - (Buhariu)

PËRKUSHTIMI GJATË AGJËRIMIT TË RAMAZANIT DUHET TË JETË SHUMËFISH MË I MADH DHE NË FORMËN MË TË PLOTË E TË MË MIRË, PASI ZOTI E SHKROI DHE E OBLIGOI AGJËRIMIN E KËTJ MUAJI TË BEGATË, QË NE BËHEMI MË TË PËRKUSHTUAR, DHE KY PËRKUSHTIM NUK DO TË THOTË NDRYSHJE, VEÇSE TË KRYEJMË URDHRAT E TIJ DHE TË LARGOHEMI TËRËSISHT PREJ NDALESAVE...

Ndërsa në një transmetim tjetër, Pejgamberi (a.s) thotë: "Agjërimi nuk është vetëm nga ushqimi dhe pija, por agjërimi është nga fjalët e kota dhe të pahijshme! Po qe se dikush të shan ose tregohet injorant ndaj teje, atëherë thuaji: Unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm." - (Ibn Khuzejme dhe Ibn Hibbani)

Le ta dimë mirë se, të gjitha adhurimet në përgjithësi, e agjërimi në rastin konkret, nuk kufizohen vetëm te lëvizjet mekanike, të cilat kryhen, apo shihen nga jashtë, por ato kryhen në

mënyrë që të ndikojnë në zemër, mendje dhe sjellje.

Të kthehemi edhe një herë te qëllimi i agjërimit të Ramazanit. Është shumë e rëndësishme, të kuptohet që në fillim se qëllimi i këtij obligimi të madh e me shumë vlerë për njeriun, nuk është vetëm përkushtimi dhe devotshmëria brenda një muaji, apo tridhjetë ditëve. Ky nuk është asnjëherë, jo vetëm qëllimi i agjërimit të Ramazanit, por edhe i asnjë prej obligimeve të tjera të Islamit.

Secili obligim në vetvete është thjesht një stacion, pikënisje, shkollë, apo trajnim prej ku besimtari parapërgatitet, stërvitet, kalitet dhe kualifikohet për gjithë pjesën tjetër të kohës dhe të jetës, jashtë këtyre obligimeve. Nuk do të kishte kuptim, që të kërkohet prej besimtarit të jetë i përkushtuar dhe i devotshëm, i ruajtur dhe i paqtë, i mirë dhe i dashur etj, vetëm gjatë kohës kur falet, kur agjëron Ramazanin, kur kryen Haxhin dhe kur jep Zekatin, ndërsa jashtë kohës së kryerjes së obligimeve, të jetojë si t'i vijë jeta, pa asnjë kontroll e disiplinë morale e jashtë kornizave, të cilat Zoti i gjithësisë ia ka caktuar! Kjo do të ishte, me të vërtetë diçka e pakuptueshme.

Kështu që, në rastin konkret për të cilin po flasim, përkushtimin e agjëruesit gjatë Ramazanit, nuk duhet ta kuptojmë e as ta imagjinojmë, që ky përkushtim kërkohet vetëm për një muaj dhe pastaj, sapo të kalojë ky muaj, agjëruesi mund të kthehet në gjendjen e tij të para-fillimit të Ramazanit. Jo, por ai duhet të jetë i bindur dhe i vendosur, madje t'i vërë vetes objektiva, të cilat, me ndihmën e Zotit duhet t'i arrijë gjatë këtij muaji agjërimi, në mënyrë që pas përfundimit të Ramazanit, me të vërtetë gjendja e tij, në të gjitha drejtimit, fetare, morale, shoqërore etj, të jetë rregulluar, përmirësuar dhe në të njëjtën kohë t'i shërbejnë si energji dhe ushqim për periudhën tjetër pas Ramazanit, për njëmbëdhjetë muajt e tjerë të vitit.

Të mos harrojmë se ditët e agjërimit të Ramazanit janë koha dhe ditët më të mira, më të favorshme dhe më ideale, që mund t'i shërbejnë dikujt për rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes së tij. Sepse kur Pejgamberi (a.s) thotë: "Kur vjen Ramazani hapen dyert e xhenetit, mbyllën dyert e xhehenemit dhe prangosen shejtanët". - (Muslimi), sikur do të na thotë se aftësia dhe mundësia e njeriut për të vepruar mirë është shumë e madhe, ndërsa

prirja e tij për të punuar dhe vepruar keq, është ose zero, ose shumë e vogël dhe e papërfillshme.

Nëse një njeri për një muaj vepron mirë, sillet mirë, flet mirë dhe në të njëjtën kohë, largohet tërësisht prej çdo të keqe, e çfarëdo lloji qoftë ajo, sjellje, fjalë, shikim, dëgjim, veprim etj, nuk ka dyshim se kjo periudhë një mujore është krejt e mjaftueshme, që ky person të transformohet në një njeri të përkushtuar e të devotshëm, që është edhe esenca dhe qëllimi i agjërimit dhe pastaj të vazhdojë kohën dhe muajt tjerë të vitit, si besimtar i mirë e me sjellje të mirë. Nëse agjërojmë në këtë mënyrë e me objektiva të tilla, atëherë besoj se na përfshin hadithi i Pejgamberit (a.s), ku thotë: "Kush e agjëron Ramazanin me besim, bindje dhe vendosmëri, atij i falen të gjitha gjynahet e kaluara". - (Buhariu dhe Muslimi)

Në mbyllje dhe në mënyrë që përmes agjërimit të Ramazanit të arrihet qëllimi, të cilin e ka vendosur Zoti (xh.sh), "në mënyrë që të bëheni të devotshëm", duhet që agjëruesi të paktën, të kryejë gjatë Ramazanit më kujdes dhe në mënyrë të rregullt e të vazhdueshme tre pika:

Falja e rregullt dhe në kohë e pesë vakteve të namazit.

Falja e namazeve synete ditore të Pejgamberit (a.s) dhe veçanërisht: Faljen e namazit të teravisë, që është i veçantë për muajin e Ramazanit, siç thotë edhe vetë Pejgamberi (a.s): "Allahu i Lartësuar jua ka bërë obligim agjërimin e Ramazanit, ndërsa unë jua kam bërë sunet (traditë) namazin e tij (teravinë). Kështu që, kush e agjëron Ramazanin dhe falë teravinë, me besim, me bindje dhe vendosmëri, ai njeri do të dalë nga Ramazani i pastër nga gabimet, si ditën që e ka lindur nëna e tij." - (Nesaiu)

Leximi i plotë i Kur'anit Famëllartë (hatme), por me meditim dhe duke e kuptuar.

Në fund po e mbylli me hadithi e transmetuar nga Nëna e besimtarëve, Aishja (r.a), e cila tregon se: "Pejgamberi (a.s) bënte adhurim gjatë muajit të Ramazanit, aq sa nuk bënte ditëve të tjera dhe muajve të tjerë. Ndërsa në dhjetë ditët e fundit (të Ramazanit) bënte adhurim më shumë se ditëve të tjera." - (Muslimi)

Allahu i Madhëruar na e pranoftë agjërimin dhe gjithë adhurimin e përkushtimin tonë! Amin



"Çdo punë

E SHOQËRUAR

ME INJORANCË,

OSE ME EKSTREMIZËM

E QODET ISLAMIN

"PËR VDEKJE"

DHE E BËN

TË ZOTIN E SAJ,

(PA E DITUR),

NDIHMËTAR TË ARMIQVE

TË KËSAJ FEJE!"

Sheikh Muhammed El-Gazali



Durim Kasemi

Imam, xhamia Parrucë

Muaji i Ramazanit është muaji i garimit për punë të mira, muaji i përpjekjeve maksimale për të arritur kënaqësinë dhe shpërblimin e Allahut. Është muaji i mundësisë së përfitimit nga fladeti e mëshirës hyjnore që fryjnë herë pas here. Pejgamberin (a.s) ka thënë: “Bëhuni punëmirë gjithmonë dhe mundohuni të përfitonin nga fladeti e mëshirës hyjnore, sepse Allahu shpesh herë dërgon flade mëshiruese të cilat përfshijnë kë të dojë Allahu nga robërit Tij”.- (Silisile Essahiha, nr .1890). Dhe muaji i begatë i Ramazanit është një ndër këto flade të kësaj mëshire.

Kështu, muslimani i urtë dhe që ia dëshiron vetes të mirën, duhet ta shfrytëzojë muajin e Ramazanit. Muslimani duhet të shfrytëzojë kohën dhe të interesohet për atë që i bën dobi në ahiret. Muslimani në këtë muaj të begatë duhet të ketë gjithmonë parasysh thënien e Hasan Basriut në të cilën thotë: “Allahu e ka bërë muajin e Ramazanit kohë për të garuar krijesat drejt kënaqësisë së Tij, dhe ata që u përpoqën fituan, kurse ata që nuk u munduan aspak, humbën” - (Ihja Ulumiddin, El-Gazali, 1/136)

Kur përmendet muaji i Ramazanit, menjëherë në mendje të vjen leximi i Kura’nit. Kjo lidhshmëri buron nga vetë fakti se Kur’ani ka filluar të zbrisë në këtë muaj të begatë. Allahu i Madhëruar thotë: “Muaji i Ramazanit në të cilin ka zbritur Kur’ani”. – (El-Bekare: 185). Për këtë arsye edhe Pejgamberi (a.s) në këtë muaj lexonte dhe përsëriste Kur’anin më shumë se në çdo muaj tjetër të vitit, siç edhe tregohet në hadithin që e transmeton (Buhariu, nr.6, dhe Muslimi, nr.2308), në të cilin thuhet që “Gjatë muajit të Ramazanit Xhibrili (a.s) zbrishte dhe i përsëriste Pejgamberit (a.s) Kur’anin”. Muaji i Ramazanit nuk ka kuptim pa leximin e Kura’nit, sepse ndryshe ky muaj quhet edhe muaji i Kuranit.

Leximi i Kur’anit, meditimi dhe mësimi i tij, është një prej adhurimeve më të vlefshme, veçanërisht në këtë muaj të begatë e plotë mirësi. Kur’ani është

RAMAZANI, SI MUAJ I KUR’ANIT

mirësi e madhe që i është dhënë njeriut nga Allahu Fuqiptotë. Mirësi, që rob i asnjëherë nuk e përmbushë falënderimin dhe mirënjohjen e duhur ndaj Allahut për të. Vetë Allahu na mëson për këtë ku thotë: “Falënderimi i takon vetëm Allahut, i cili i zbriti robit të Tij – Muhamedit – Kur’anin, në të cilin nuk ka shtrembërime e devijime nga e vërteta”. – (El-Kehf: 1)

Kurani është burim i pashtershëm mirësish. Leximi i tij është një ndër këto mirësi dhe, mjafton të përmendim vetëm disa prej ajeteve dhe haditheve profetike që flasin për këtë temë, për ta kuptuar këtë. Pejgamberi (a.s) thotë: “Kush lexon një gërmë nga libri i Allahut, për të ka një sevap dhe ai (sevapi) shumëfishohet në dhjetë të tilla, dhe deri në shtatëqind fish”. - (Tirmidhiu, nr.2910, Sahih).

Nisur nga kjo, është interesante të dimë se; Kur’ani ka reth 32.000 shkronja (Tefsiri Ibn Kethir, parathënie, 1\15), dhe sipas një përllogaritjeje të thjeshtë, një faqe Kur’ani mesatarisht përmban rreth 600 germa dhe, vetëm nga leximi i një faqeje të vetme prej Kur’anit, muslimani merr rreth 6000 sevape minimalisht. Kurse nga një hatme e plotë e Kur’anit, muslimani fiton minimalisht 3,200,000 sevape; vallahi, mirësi e madhe dhe e pakrahasueshme me asnjë të mirë materiale në këtë botë.

Muslimanët e parë, gjeneratat e ndritura të Islamit, shembujt tanë në punë të mira dhe ibadete, e kanë kuptuar më së miri këtë rëndësi dhe i kanë dhënë hakun siç i takon asaj. Shembujt e përkushtimit të tyre në leximin e Kur’anit gjatë muajit të Ramazanit janë të panumërt, por, do përmend vetëm disa të tillë.

Sahabet e Pejgamberit (a.s) kalonin pothuajse gjithë natën duke u falur dhe duke lexuar Kur’an, sa që mbështeteshin në shkopinj nga lodhja e qëndrimit të gjatë në këmbë. - (Kijamu Ramadan, Albani, fq.24)

Imam Shafiu vetëm gjatë muajit të Ramazanit i bënte hatme Kur’anit 60 herë. (Letaifu El-Mearif, Ibn Rexheb, fq.318). Dikush mund të pyes i çuditur; po si ka mundësi të ndodhë kjo?! Po të nderuar, ndodhë sepse ata, muslimanët e parë nuk e kanë humbur kohën sikur ne, nuk e kanë shpenzuar kohën e ramazanit të tyre duke fjetur me nga dymbëdhjetë orë, a më shumë, nuk kanë bërë biseda boshe dhe shterpë, nuk e kanë vlarë kohën para televizorit dhe kompjuterit.

Imam Zuhriu, kur hynte Ramazani, thoshte: Ky muaj është vetëm për leximin e Kur’anit dhe ushqyerjen e të varfërve, dhe vetëm me ato merrej. (Letaifu El-

Mearif, Ibn Rexheb, fq.318).

Imami Sufjan Eth-Theurij, kur hynte Ramazani, linte çdo adhurim tjetër dhe merrej vetëm me leximin e Kuranit. (Letaifu El-Mearif, Ibn Rexheb, fq.360).

Ata, muslimanët e parë, kanë qenë kaq të përkushtuar, sepse e kanë ditur vlerën e Kur’anit dhe leximit të tij. Ata e kanë ditur se Kur’ani do jetë ndërmjetësues për ata ditën kur do dalin para Krijuesit të tyre për të dhënë llogari. Atë ditë kur rob i nuk do ketë askënd afër dhe në ndihmë, por vetëm punët e tij të mira. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Agjërimi dhe Kur’ani do jenë ndërmjetësues për robin ditën e gjykimit përpara Zotit. Agjërimi do i thotë: O Zot im, i kam ndaluar atij ushqimin dhe kënaqësitë gjatë ditës, kështu që pranoje ndërmjetësimin tim. Kurse Kur’ani i thotë: O Zoti im, unë i kam privuar atij gjumin gjatë natës, kështu që pranoje ndërmjetësimin tim për të, dhe ndërmjetësimi i tyre pranohet”. - (Ahmed, nr.6626, Sahih)

Të nderuar besimtarë dhe besimtare! Kur do i vlerësojmë gjërat ashtu siç duhet?! Kur do të ndërgjegjësohemi se jeta e vërtetë është jeta nën hijen e Kur’anit Famëllartë!? Kur do e kuptojmë se Kur’ani është ilaçi më i mirë për zemrat dhe trupin tonë. Kur do e kuptojmë se Kur’ani është ilaçi më i mirë për brengat, stresin, dhe ngarkesën e madhe psikologjike që na e ka imponuar mënyra e të jetuarit në kohën e sotme. Allahu, Krijuesi jonë dhe i gjithësisë na tregon dhe thotë: “O njerëz, ju ka ardhur një këshillë (Kur’ani) nga Zoti juaj, i cili është ilaç për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët”. – (Junus: 57)

Kur’ani është melhem për zemrat e mbytura në llumin e materializmit. Është dritë dhe udhërrëfyes për mendjet që kanë humbur rrugën në rrugëtimin e jetës dhe nuk dinë se nga shkojnë. Allahu na tregon e thotë: “Thua: “Ai – Kur’ani -, për besimtarët është udhërrëfyes dhe ilaç”. – (Fussilet: 44) Kur’ani është qetësues për zemrat e trazuar në këtë botë. Allahu thotë: “Me të vërtetë, me përmendjen e Allahut qetësohen zemrat”. – (ER-Ra’d: 28)

Lexuesi i Kur’anit, ai që e kupton atë dhe që punon me të, ka një pozitë të veçantë tek Allahu Fuqiptotë. Pozitë që nuk e ka askush tjetër në botë, përveç lexuesi i Kur’anit. Kjo pozitë është pozita e të qënurit mik i afërt dhe i veçantë i Allahut të Madhëruar, Krijuesit të çdo gjëje. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu ka përzgjedhur disa njerëz si më të afërmit tek Ai”. Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut? – pyetën sahabet. Ai u përgjigj:



Idmir Plaku

Imam, xhamia "Ebu Bekër"

Në këto pak ditë të mbetura nga muaji Shaban në zemrat e çdo besimtari zë vend ndjenja e mallit për muajin e Ramazanit, muajin e mirësive të shumta, muajin e ibadeteve të veçanta, muajin e shpërblimeve të mëdha. Ky mall tek besimtarët vjen natyrshëm për zemra të pastra me nijete të singqerta. Këto zemra që ushqim kanë besimin në Allahun (xh.sh), ndjejnë kënaqësi në kryerjen e ibadeteve dhe në përjetimin e muajit të Ramazanit.

Këtë ndjenjë malli për Ramazanin e shprehu edhe Pejgamberi (a.s) në thënien e tij profetike: “O Allah, na begato në muajt rexhep dhe shaban dhe na mundëso përjetimin e muajit Ramazan”¹.

Ky është muaji i diferencës së veprave si në jetën e kësaj bote ashtu edhe në jetën tjetër. Transmetohet nga Talha (r.a) se: Dy vëllezër nga sahabet, njëri luftoi dhe ra shehid, ndërsa tjetri vdiq pas një viti. Këta dy vëllezër iu shfaqën në gjumë Talhes (r.a), i cili pa se vëllai që vdiq pas një viti ishte në pozitë më të lartë se tjetri. Këtë ua tregoi edhe sahabeve, por të gjithë u habitën! Më pas i dëgjoi Pejgamberi (a.s) e u tha: “Ky burri që vdiq pas një viti, a e përjetoi Ramazanin, agjëroi dhe fali namaz, sa e sa sexhde namazi ka bërë gjatë një viti?! Thanë: po. Atëherë Pejgamberi (a.s) tha: “Vërtetë që pozita mes tyre është më larg se ajo mes qiellit e tokës”.

Në këtë hadith u vu theksi tek përjetimi i Ramazanit, i cili është i karakterizuar me

1. Ahmedi.

“Ata janë lexuesit e Kur’anit, ata që e mësojnë dhe jetojnë me Kur’anin” (Ibn Maxheh, nr. 215, Sahih)

Lexuesi i Kur’anit është i nderuar në këtë botë dhe në ahiret. Lexuesi i Kur’anit vazhdon të marrë shpërblimin e tij edhe në ahiret dhe kjo është vetëm për lexuesin e Kur’anit. Pejgamberi (a.s) thotë: “Lexuesit të Kuranit do t’i thuhet në ditën

VLERA E NAMAZIT TË TERAIVISË

adhurime të veçanta që dallohet nga muajt e tjerë. Një ndër këto adhurime është edhe namazi i teravisë. Ky namaz është i veçantë në netët e Ramazanit, me vlerë e shpërblim të madh tek Allahu (xh.sh). Vlerën e këtij namazi në netët e Ramazanit e shprehu Pejgamberi (a.s) duke thënë: “Kush i kalon netët e Ramazanit duke bërë adhurim me besim të plotë dhe duke shpresuar në shpërblimin e Tij, do t’i falen të gjitha mëkatet e tij të mëparshme”².

Vlera e madhe e namazit të teravisë u vërejt edhe në përkujdesjen që Pejgamberi (a.s) i kushtoi, si në tre netët e para që e fali me xhemat, duke zgjatur në leximin e Kur’anit, por edhe në natën e katërt që nuk e fali me xhemat. Këtë vlerë të madhe të këtij namazi e shprehu duke thënë: “U frikësova se mos po ju bëhet farz namazi i natës e nuk keni mundësi t’i përmbaheni”³.

Këtë gjë e kuptuan më së miri sahabët, të cilët vazhduan ta falnin këtë namaz grupe-grupe deri në kalifatin e Omerit (r.a), i cili i kushtoi kujdes kësaj tradite profetike duke i ruajtur frymën e faljes me xhemat dhe vlerën e madhe të tij. Pa dyshim se një veprim i tillë i Omerit (r.a) u mirëprit dhe nuk u kundërshtua nga asnjë nga sahabët dhe ata që vazhduan të ecin në rrugën e tyre⁴.

Falja me xhemat e këtij namazi ndonëse është sunet dhe mund të falet edhe individualisht tregon vlerën e madhe që ai ka kur falet pas imamit. Për këtë Pejgamberi (a.s) ka porositur duke thënë: “Njeriu, i cili falet me imam deri në fund, i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën”. Në kontekst të këtij hadithi, Shejkh Uttejmini thotë: “Nuk duhet të largohet nga namazi derisa ta përfundojë imami namazin e teravive, si dhe vitrin që ta arrijë vlerën apo shpërblimin e namazit të natës”⁵.

Përsa i përket numrit të rekatëve të teravive, ai është njëzet, sipas shumicës

2. Buhariu dhe Muslimi.

3. Buhariu dhe Muslimi.

4. Po kështu vazhduan të faleshin edhe në kohën e Othmanit dhe Aliut (r.a).

5. Shih: “Fetava Shejkh Uttejmini”.

së dijetarëve. Por duke qenë një nemaz nate edhe diversiteti i mendimeve mes dijetarëve në përcaktimin e numrit të rekatëve ka qenë prezent në mesin e besimtarëve. Diversiteti i mendimeve të dijetarëve në ditët e sotme duhet të kuptohet si mëshirë ashtu siç e kuptuan brezat e parë të besimtarëve, të cilët ruajtën frymën e xhematit dhe të vëllazërisë mes tyre, si një vlerë e qëllim i këtij namazi në këtë muaj të madhnueshëm.

Falja e namazit të teravive gjatë Ramazanit është një mirësi e Allahut për besimtarët. Kjo tregohet edhe në thënien e Pejgamberit (a.s): “Allahu e bëri farz agjërimin ditën dhe namazin e teravisë e bëra sunet gjatë natës”⁶. Sikurse agjërimi ditën ashtu edhe namazi i teravive natën janë veçori të këtij muaji ripërtëritje besimi në zemrat e çdo besimtari.

Duke parë rëndësinë dhe vlerën e madhe që ka ky namaz në muaj të Ramazanit, Shejkh Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Besimtari ka vepruar mirë e drejtë nëse fal namazin e teravive, pavarësisht numrit të rekatëve. Kush mendon që namazi i teravive ka numër të caktuar nga Pejgamberi (a.s), që nuk i shtohet dhe as i pakësohet, vërtet që ka gabuar”⁷.

Falja e namazit të teravive natën ka urtësi hyjnore, sepse është shenjë sakrice e përkushtimi e besimtarit për tu afruar dhe arritur kënaqësinë e Allahut. Allahu (xh.sh) i përshkruan kështu falësit e namazit natën: “I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe shpresa”. – (Es-Sexhde: 16) Prandaj me faljen e namazit të teravive, besimtari duhet të synojë çlodhjen, qetësinë shpirtërore dhe marrjen e shpërblimeve. Allahu na bëftë prej atyre besimtarëve që e përjetojnë qetësinë shpirtërore në këtë namaz.

I lutemi Allahut që të na mundësojë përjetimin e këtij muaji të madhnueshëm.

6. Muslimi.

7. Fetava, Shejkhul-Islam Ibn Tejmije, 2/401.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Allahu me këtë libër disa i lartëson dhe, disa të tjerë i ulë”. - (Muslimi, nr. 817)

Prandaj, motër dhe vëlla besimtar, lexoje Kur’anin dhe mos e lësho kurrë nga dora gjatë gjithë muajit të Ramazanit që të fitosh në këtë botë dhe në tjetrën.

AKTIVITETE TË BEGATA GJATË MUAJIT MAJ 2017

FSHATI I RI, POSTRIBË



XHAMIA "EBU BEKËR"



PRANË XHAMISË SË PARRUCËS



XHAMIA KRYEBUSHAT



XHAMIA TOPHANË



XHAMIA KIRAS



XHAMIA E "DY VAJZAVE"



KULLAJ, POSTRIBË





Ruzhdi Plangaj
Imam, xhamia Kiras

RAMAZANI ËSHTË MUAJI I XHEMATIT

“Sikur të mos kishte qënë populli yt kaq afër me kohën e injorancës paraislame (ata e pranuan Islamin shumë vonë dhe janë të rinj ne fe) dhe po të mos kisha frikë se ata do të shprehnin pakënaqësi për këtë gjë, atëherë do ta kisha përfshirë edhe zonën e murit rrethor në ndërtesën e Qabes (hixhrin), si dhe do ta kisha ulur derën e saj rrafsh me token”²

Muaji i Ramazanit është muaji i xhematit (bashkimit), sepse ne hyjmë në këtë muaj me hyrjen e hënës së Ramazanit, të gjithë njëherazi, dalim prej këtij muaji me hyrjen e hënës së Shevalit të gjithë njëherazi. E fillojmë ditën e agjërimit me hyrjen e agimit të gjithë njëherazi dhe e mbyllim ditën e agjërimit, pas përdimit të diellit të gjithë njëherazi. Falim namazin e teravive bashkërisht me xhemat dhe prezantojmë në iftare të përbashkëta, etj.

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Agjërimi fillon atë ditë kur agjëroni të gjithë. Dita e Fitër Bajramit është atë ditë kur të gjithë bëni Fitër Bajram (çelni), dhe dita e Kurbanit është atë ditë kur të gjithë bëni kurban”.

SI TA KTHEJMË KËTË MUAJ NË MUAJIN E XHEMATIT

Falja e namazeve ditore si dhe e namazit të teravive me xhemat, ku bashkohen zemrat dhe trupat, i drejtohem Allahut Një të Vetëm. Drejtohem të gjithë drejt një kible të vetme si dhe shpresojmë që të marrim nga Allahu shpërblime. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Namazi me xhemat është më i mirë se namazi i personit që falet vetëm, 27 herë”.

Ndërsa ka thënë për namazin e teravive që falet me xhemat: “Kush falet me imamin derisa ai të largohet, i shkruhet atij sikur është falë gjithë natën”.

Largimi nga polemikat dhe keqkuptimet e pafytyshme, si dhe shtimi i dashamirësisë, mirëkuptimit dhe mendimit të mirë për tjetrin, sepse në këtë muaj lidhen shejtanët dhe dobësohen cytjet e ndikimi i tij mbi njeriun. Enes ibn Malik (r.a) transmeton se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Nuk do të besojë asnjëri prej jush, derisa të dojë për vëllanë e tij, atë që do për vete”.³

Largimi nga vetëpërlqimi dhe mendjemadhësia, sepse Allahu (xh.sh) ka shkatërruar me të, tre zullumqarët më te mëdhenj:

2. Sahihul- Buhari: 1584.
3. Sahihul-Buhari: 16.

Iblisin - Ai (Iblisi) tha: “Unë jam më i miri prej tij, mua më ke krijuar nga zjarri, e atë e krijoje nga balta!”

Faraonin - E u tha: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”

Karunin - Ai (Karuni) tha: “Më është dhënë vetëm në saj të dijes sime!” Po a nuk e di ai se All-llahu shkatërroi para tij nga popujt e lashtë asish që ishte edhe më i fuqishëm e më i pasur se ai, po mëkatarët kriminelë as që do të pyeten për faje e tyre (meqë All-llahu e di”).

Përpjekja për të qënë afër njëri-tjetrit në të gjitha problematikat dhe hallet që ndonjëri nga ne ka, duke shpresuar për çdo hap tonin shpërblim nga Zoti i gjithësisë. Transmeton Abdullah ibn Umeri (r.a) se, Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Njerëzit më të dashur tek Allahu janë ata që janë më të dobishëm për njerëzit, ndërsa punët më të dashura tek Allahu janë kënaqësia që ti fut në zemrën e muslimanit, apo t'i largosh atij një brengë, apo t'i shlyesh një borxh, ose t'i largosh urinë dhe me ecë me vëllanë tim për një nevojë të tij, është më e dashur për mua se sa me bë itikaf në këtë xhami –ka për qëllim xhamin e Medinës- një muaj; kush ndalohet prej nervozizmit, Allahu do t'ia mbulojë të metat, kush e mban zemërimin dhe po të dojë ka mundësi të hakmerret, do t'ia mbushë Allahu zemrën e tij me shpresë në ditën e gjykimit, dhe kush ecë me vëllanë e tij në një nevojë të tij, deri sa ta kryejë atë, do ia forcojë Allahu këmbët atë ditë kur dridhen këmbët”.⁴

Njohja dhe meditimi i teksteve të shumta, të cilat flasin për vëllazërinë dhe vlerën e saj.

S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kine frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti”).

“Nuk ka dyshim se ata që bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t'u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri”.

Shtimi i lutjes për njëri-tjetrin, për përmirësimin e gjendjes tonë etj dhe sidomos në këtë muaj, i cili është muaji i bashkimit, afrimitetit si dhe pranimit të lutjeve. Në hadithin që e transmeton Enes ibn Maliku (r.a) Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Tre lutje nuk refuzohen: lutja e prindit për fëmijën e tij, lutja e agjëruesit dhe lutja e udhëtarit”.⁵

4. Es-Silsiletu es-Sahihah: 906.
5. Sahihul-Xhamiu: 3032, hasen.

INSPEKTOHEN DY XHAMI NË PRAG TË PËRURIMIT

Ditën e martë, më 2 maj 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi në terren dy nga katër xhamitë e reja, që priten të inaugurohen së shpejti në Shkodër.

Fillimisht, Myftiu u ndal në Krye-Bushat dhe më pas në Bërdicën e Mesme, ku thuajse kanë përfunduar dy xhamitë e reja, falë bashkëpunimit me Fondacionin “Mirësia” dhe Institutin Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam.

Myftiu shprehu vlerësimet e tij për arritjet e deritanishme, sikurse theksoi se gjatë këtyre viteve është mundësuar përmirësimi i infrastrukturës së xhamive, me ndërtime të reja, restaurime, ndërtime minaresh dhe projekte të larmishme në dobi të xhemateve tona.

Me mbarësinë e All-llahut, pritet që së shpejti, xhamitë e reja të hapin dyert e tyre për besimtarët dhe frekuentuesit e tyre.



KALENDARI I LIGJËRATAVE NË PRAG TË RAMAZANIT 1438/2017

Ditën e martë, më 2 maj 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët teologë të Shkodrës, ku diskutoi rreth programit të ri të ligjëratave në prag të Ramazanit të sivjetshëm.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve me dobi, u ra dakord për zhvillimin e ligjëratave, sipas programit paraprak.

Aktivitetet në kuadër të Muajit Ramazan do të vazhdojnë, si një traditë e bukur dhe e konsoliduar tashmë në qytetin e Shkodrës.

Ligjëratat e këtyre tubimeve do të botohen në gazetën "Udha Islame", sidhe në një botim të posaçëm me rastin e Ramazanit 1438/2017.

E ENJTE, 4 MAJ 2017, ora 18-00 XHAMIA "EBU BEKËR"	1. Ramazani, muaji i rimëkëmbjes - IMAM MUHAMED SYTARI
	2. Përkushtimi, si bosht esencial në jetën e agjëruesit - LAVDRIM HAMJA
	3. Ramazani, si muaj i Kur'anit - DURIM KASEMI
	4. Vlerat e namazit të teravisë - IDMIR PLAKU
E HËNË, 8 MAJ 2017, ora 18-00 XHAMIA "DY VAJZAVE"	1. Ramazani, muaj i agjërimit ndër shekuj - ARBEN HALLUNI, ERVIL KUÇI
	2. Agjërimi tek sahabët (r.a) - NAIM DRIJAJ
	3. Agjërimi dhe shëndeti - ADEM PIZGA
E ENJTE, 11 MAJ 2017, ora 18-00 XHAMIA KIRAS	1. "Muaji i Ramazanit, në të cilin zbriti Kur'ani" - ALTIN NIKSHIQI
	2. Ramazani, muaji i xhematit - RUZHDI PLANGAJ
	3. Ramazani, muaji i bamirësisë - LAVDRIM HAMJA
E HËNË, 15 MAJ 2017, ora 18-00 XHAMIA TOPHANË	1. Ramazani, si mundësi paqtimi me Zotin (xh.sh) - IDMIR PLAKU
	2. Ramazani në jetën e Resulull-llahut (a.s) - ADIL CUKALI
	3. Nata e Kadrit, më e mirë se 1000 muaj - NAIM DRIJAJ

XHAMIA “EBU BEKËR”, PASDITE E BEGATË NË PRAG TË RAMAZANIT 1438

Pasditën e së enjtes, më 4 maj 2017, ashtu si ishte lajmëruar më parë, Myftinia Shkodër nisi ligjëratat e larmishme në prag të Ramazanit 1438/2017.

Sipas programit të lajmëruar, u zhvilluan katër ligjëratat e para:

1. “Ramazani, muaji i rimëkëmbjes”, nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.
2. “Përkushtimi, si bosht esencial në jetën e agjëruesit”, nga imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja.
3. “Ramazani, si muaj i Kur’anit”, nga imami i xhamisë së Parrucës, teologu Durim Kasemi.
4. “Vlerat e namazit të teravisë”, nga imami i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Idmir Plaku.

Ndërkohë, aktiviteti u përshëndet edhe nga H. Edmir Smajlaj, Myfti i Malësisë së Madhe, i cili uroi suksese në këtë iniciativë të re plot dobi të Myftinisë Shkodër, sikurse uroi që Ramazani i sivjetshëm të jetë sa më i mbarë dhe me begati për krejt besimtarët.



Pasditën e së hënës, më 8 maj 2017, në vazhden e ciklit të ligjëratave në prag të Ramazanit 1438/2017, Myftinia Shkodër organizoi në ambientet e jashtme të xhamisë së “Dy Vajzave” një pasdite të larmishme me tematika të dobishme rreth vlerave dhe dobive të Muajit të Begatë të agjërimit.

Në hapje të këtij tubimi me vlerë, imami i xhamisë, teologu Lavdrim Hamja theksoi se ky cikël aktivitetesh ka për qëllim sensibilizimin e xhemateve dhe masës së qytetarëve me vlerat dhe dobijtë e agjërimit të Muajit Ramazan dhe forcimin e marrëdhënies me fenë dhe besimi.

Ai tha se Ramazani është muaj në të cilin jemi të ftuar drejt pendimit, adhurimit, faljes dhe bamirësisë.

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vlerësoi se tubime të tilla kanë një përfundim të madh e të garantuar, qoftë në aspektin besimor, intelektual e shpirtëror.

Sipas programit, u prezantuan ligjëratat e mëposhtme:

1. “Ramazani, muaj i agjërimit ndër

XHAMIA E “DY VAJZAVE”, VIJOJNË LIGJËRATAT NË PRAG TË RAMAZANIT 1438



shekuj”, përgatitur nga teologët Arben Halluni dhe Ervil Kuçi.

2. “Agjërimit tek sahabët (r.a)”, nga imami i xhamisë Parrucë, teologu Naim Drijaj.

3. “Agjërimit dhe shëndeti”, nga imami i xhamisë Perash, teologu Adem Pizga.

Për të pranishmit u shpërnda edhe numri i ri i gazetës “Udha Islame”, si dhe kalendarët e Muajit Ramazan 1438/2017.

XHAMIA E KIRASIT, LIGJËRATA TË DOBISHME MBI VLERËN E RAMAZANIT

Pasditën e së enjtes, më 11 maj 2017, në vijim të ciklit të ligjëratave në prag të Ramazanit 1438/2017, Myftinia Shkodër organizoi në ambientet e jashtme të xhamisë së Kirasit një pasdite të larmishme me ligjëratat të dobishme mbi mirësitë dhe dobijtë e Muajit të Begatë të Ramazanit.

Aktiviteti u përshëndet fillimisht nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili dha lajmin e gëzueshëm dhe të shumëpritur për nisjen e procedurave për ndërtimin e xhamisë së re të lagjes Kiras.

Myftiu theksoi se pas mirëkuptimit të shfaqur nga Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, tashmë kërkesa e Myftinisë Shkodër po shqyrtohet në Kryesinë e KMSH-së dhe shumë shpejt pritet nënshkrimi i marrëveshjes me shoqatën donatore.

Sipas programit, u prezantuan ligjëratat e mëposhtme:

1. “Muaji i Ramazanit, në të cilin zbriti Kur’ani”, përgatitur nga imami i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Altin Nikshiqi.
2. “Ramazani, muaji i xhematit”, përgatitur nga imami i xhamisë Kiras,



teologu Ruzhdi Plangaj.

përgatitur nga imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja.

3. “Ramazani, muaji i bamirësisë”,

XHAMIA E TOPHANËS, NJË PASDITE E BUKUR FETARE NË PRAG TË RAMAZANIT

Pasditën e së hënës, më 15 maj 2017, në vijim të ciklit të ligjëratave në prag të Ramazanit 1438/2017, Myftinia Shkodër organizoi në oborrin e xhamisë së Tophanës një tubim të dobishëm me ligjëratat të ndryshme mbi mirësitë dhe dobijtë e Muajit të Ramazanit.

Sipas programit, u prezantuan ligjëratat e mëposhtme:

1. “Ramazani, si mundësi paqtimi me Zotin”, përgatitur nga imami i xhamisë “Ebu Bekër”, teologu Idmir Plaku.
2. “Nata e Kadrit, më e mirë se 1000 muaj”, përgatitur nga imami i xhamisë Parrucë, teologu Naim Drijaj. Ndërkohë, për arsye shëndetësore mungoi teologu Adil Cukali, që ishte lajmëruar më parë në kalendarin e këtyre ligjëratave.

Në fund, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dha një mesazh për krejt qytetarët muslimanë, të cilët i ftoi të agjërojnë duke mos e konsideruar fenë si një rëndesë e barrë në jetë, por si një mundësi për përsosjen e mënyrës së jetesës, për të arritur dinjitetin e të qenurit njeri!



XHAMIA KULLAJ, TUBIM VLERASH NË PRAG TË RAMAZANIT

Pasditën e së martës, më 16 maj 2017, në kuadër të ciklit të ligjëratave në prag të Ramazanit 1438/2017, Myftinia Shkodër organizoi në oborrin e xhamisë së fshatit Kullaj një aktivitet të dobishëm me ligjërata të ndryshme mbi vlerat e Muajit të Ramazanit në edukimin e individit, familjes dhe shoqërisë, si dhe mënyrat e shfrytëzimit të kohës gjatë këtij muaji.

Atmosfera e këtij tubimi, shoqëruar nga bukuria e natyrës dhe ambientet e reja të xhamisë, ia shtuan edhe më shumë madhështinë këtij aktiviteti me vlerë.

Imamët e nderuar trajtuan me shumë pjekuri temat e tyre të mbushura me argumente dhe momente reflektimi, sikurse u theksua domosdoshmëria e shfrytëzimit të Ramazanit si një muaj ndryshimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

Sipas programit, u prezantuan ligjëratat e mëposhtme:

1. “Agjërimi, si trajnim edukues i karakterit të muslimanit”, Imam Muhamed B. Sytari.
2. “Ramazani, muaj i harmonisë islame”, teologu Ruzhdi Plangaj.
3. “Si ta shfrytëzoj Muajin e agjërit?”, teologu Durim Kasemi.



XHAMIA OBLIKË, NJË PASDITE ME LIGJËRATA TË LARMISHME MBI RAMAZANIN

Pasditën e së mërkurës, më 17 maj 2017, në vijim të ciklit të ligjëratave në prag të Ramazanit 1438/2017, Myftinia Shkodër organizoi në oborrin e xhamisë së fshatit Oblikë, Ana e Malit, një aktivitet të dobishëm me ligjërata të larmishme mbi vlerat e Muajit të Ramazanit në ngulitjen e besimit në jetë, pastrimin e individit dhe shoqërisë nga veset, lëngatat, smira e zilia, përgojimi e mosrespekti në familje e farefis, afetarizmi dhe zhveshja nga

moralit i besimit etj.

Të pranishmit ndoqën me vëmendje ligjëratat e imamëve të nderuar, që u paraprinë nga një mesazh i mbajtur nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili nxiti leximin e duhur të ajeteve dhe haditheve të përkushtimit, që forcojnë vetëdijen islame dhe ecurinë e muslimanit në jetë.

Sipas programit, u prezantuan ligjëratat e mëposhtme:

1. “Agjërimi dhe forcimi i marrëdhënieve familjare”, nga imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja.
2. “Ramazani, muaj i qetësisë shpirtërore”, nga imami i xhamisë së Dudasit, teologu Adrian Uraj.
3. “Edukata e agjëruessit: Unë jam agjëruesshëm!”, nga imami i xhamisë së Dërgutit, teologu Ervil Kuçi.



Pasditën e së enjtes, më 18 maj 2017, në një atmosferë të mrekullueshme besimi, harmonie kombëtare dhe vëllazërie islame, u zhvillua ceremonia e inaugurimit të xhamisë së re në Krye-Bushat.

Ceremonia nisi me këndimin e një pjese kur'anore nga imami i xhamisë, Hafiz Shukri Kapllan.

Më pas, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, përhaproi të pranishmit për këtë xhami të re, të cilën e cilësoi si një sihariq hyjnor në prag të Muajit Ramazan.

Në fjalën e tij, Myftiu vuri theksin te domosdoshmëria që ka sot, ndërtimi i xhamive të reja si dhe përhapja e mësimave të besimit, harmonisë dhe paqes sociale, si vlera të domosdoshme për ndërtimin e shoqërisë dhe përjetimin e harmonisë kombëtare dhe asaj njerëzore.

Myftiu falënderoi Fondacionin “Mirësia”, drejtorin e saj, z. Korab Kaja, si dhe donatorin nga shteti mik i Kuvajtit, për përkujdesjen dhe ndjekjen me korrektësi të krejt proceseve të ndërtimit të xhamisë së re.

Kryetari i Bashkisë Vau-Dejës, z. Zef Hila, nëpërmjet urimit të tij, përgëzoi besimtarët e kësaj zone dhe premtoi se

Pasditën e së shtunës, më 20 maj 2017, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë tradicionale: “Sofra e Kur'anit”, në prag të Muajit Ramazan.

Hafizë të nderuar nga Stambolli, Ankaraja, Shkupi etj, prezantuan lexime të mrekullueshme nga Kur'ani Famëlartë.

Të nderuarit Ilham Tabak, Osman Evgin, Ibrahim Sherif, Adnan Kadri dhe Avni Hasani, e hijeshuan atmosferën e këtij prag Ramazani me leximet e tyre, që tërhoqën vëmendjen e të ftuarve të shumtë, por edhe të kalimtarëve të shumtë, që shijuan këtë mirësi besimi.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili theksoi se realitetet e sotme janë mbushur me hipokrizi dhe sëmundje morale e shpirtërore dhe se Ramazani është mundësi reflektimi dhe kthimi me pendim nga Zoti.

Myftiu u përqendrua tek lutja kur'anore: “Thuaj: Namazi im, adhurimet e mia, jeta ime dhe vdekja ime janë për All-llahun, Zotin e botrave”, duke theksur se sot, ka shumë njerëz që shesin shpirtin e fenë, dinjitetin dhe moralin, për interesa kalimtare të kësaj bote të ngushtë.

Ai kërkoi që të kthehemi nga Kur'ani dhe të gjejmë kurajon për të jetuar me dinjitet, duke mos u nënshtruar para shejtanëve të shumtë në jetë.

NË KRYE-BUSHAT U PËRURUA XHAMIA E RE



Bashkia Vau-Dejës do të sistemojë me shtrim e ndriçim edhe rrugën që shpie drejt xhamisë së re.

Nga ana e tij, z. Korab Kaja, pasi falënderoi bashkëpunimin e frytshëm me Myftininë e Shkodrës, shprehu vlerësimet e tij edhe për ekipin ndërtues, me në krye z. Ismet Fangaj, këshillin e xhamisë dhe krejt besimtarët e zonës.

Z. Kaja tha se nga ky moment xhamia e re mbetet amanet në duart e besimtarëve të kësaj zone, që kanë mundësinë ta

shfrytëzojnë dhe të edukojnë fëmijët e tyre në kushtet e xhamisë së re.

Përshëndeti ceremoninë edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, kryetari i këshillit të xhamisë, z. Zyhdë Mustafa, si dhe imami i xhamisë, H. Shukri Kapllan.

Në shoqërinë e tekbiereve u pre shiriti i përrurimit si dhe u krye falja e namazit të mesditës me xhematë.

E gëzofshim xhaminë e re!

“SOFRA E KUR'ANIT”, TEJMBUSH SHESHIN E XHAMISË PARRUCË



Pasditën e së dielës, më 21 maj 2017, Myftinia Shkodër organizoi një ceremoni fetare me rastin e përfundimit të minares së xhamisë Fshati i Ri.

Me këtë rast, në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari vuri theksin tek ajeti kur'anor: "Dhe, kushdo që madhëron simbolikat fetare dëshmon përkushtimin e zemrës".

Myftiu tha se minarja, xhamia, hixhabi, Dita e Bajramit, namazi etj, janë simbolika të shtrenjta të fesë, respektimi i të cilave dëshmon përkushtimin e zemrave.

Ai tha se ata që nuk të respektojnë simbolikat fetare, nuk të respektojnë as si njeri! Prandaj, duhet të kapemi fort pas vlerave tona dhe të mos tolerojmë mosrespektimin e tyre!

Myftiu falënderoi edhe motrën e nderuar që bëri donacion nga pasuria e saj për ndërtimin e minares së bukur të kësaj xhamie.

Përhëndeti edhe Myftiu i Malësisë, H. Edmir Smajlaj, i cili vlerësoi këtë tubim si dhe krejt ceremonitë e inaugurimeve të xhamive dhe qendrave islame, që dëshmojnë për besimin dhe vullnetin e masave për t'u afruar me vlerat islame në zonën tonë.

Aktiviteti vijoi me dy ligjërata të dobishme të mbajtura nga teologët e nderuar, Adem Puzga dhe Ruzhdi Plangaj, të cilët hodhën dritë mbi vlerat e agjërimit të Ramazanit dhe mirësitë me të cilat rrethohet ymmeti islam në këtë periudhë.

FSHATI I RI, U PËRURUA MINARJA E XHAMISË



Në mbyllje të ceremonisë, imami i xhamisë Fshati i Ri, Indrit Plangaj, falënderoi kontribuesen për minaren e

xhamisë, si dhe vëllezërit e angazhuar për rrethimin dhe mirëmbajtjen e saj në vazhdimësi.

MYFTIU DHA UDHËZIMET E TIJ NË PRAG TË RAMAZANIT 1438

Pasditën e së martës, më 23 maj 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit dhe fshatit, ku u diskutua rreth përgatitjeve të fundit për muajin Ramazan.

Gjatë takimit, u vu theksi te domosdoshmëria e ruajtjes dhe forcimit të vlerave të vëllazërisë islame dhe harmonisë në mesin e besimtarëve.

U përmenden disa nga aktivitetet dhe veprimtaritë që do të zhvillohen, iftaret e përbashkëta me krejt xhamatet e xhamive, Hatmeja e Kur'anit, çdo ditë pas namazit të iqindisë në xhaminë e Parrucës, tribunat, takimet, emisionet televizive, fushatat bamirëse etj.

Myftiu konsideroi si të domosdoshme, që njëra prej hytbeve të Ramazanit të sivjetshëm t'i kushtohet zekatit, që për këtë vit nxirret nga vlera e 85 gr. ar, ose

470.000 (lek të reja), të depozituara për një vit hënor, jashtë nevojave të konsumit të përditshëm dhe atyre bazike.

Myftiu tha se përtej faktit se ka besimtarë që vazhdojnë të nxjerrin zekatin, porse është e domosdoshme që të bëhet thirrje masive për respektimin

e këtij adhurimi, që Shkodra e ka pasur traditë shekullore.

U kujtua gjithashtu se vlera e fidjes ditore për personat e sëmurë rëndë dhe me pamundësi agjërimi është 200 (lek të reja), si dhe sadekatul-fitri 200 (lek të reja) për person.



Paraditën e së shtunës, më 13 maj 2017, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përziemë Raportuesin e Posaçëm për Lirinë e Fesë dhe Besimit pranë Kombeve të Bashkuara, z. Ahmed Shaheed, që shoqërohej edhe nga ekspertja për të drejtat e njeriut, Maken Tzeggai.

Për rreth dy orë, ata diskutuan rreth çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me lirinë e fesë dhe besimit në Shqipëri, për historikun e fesë islame në vendin tonë, vështirësitë e periudhës së komunizmit, ripërtëritjen e lirisë fetare pas vitit 1990, gjendjen aktuale të bashkësisë së muslimanëve, infrastrukturën e besimit dhe zhvillimin e saj etj.

Myftiu foli edhe për marrëdhëniet ndërfaqetare, sikurse nuk la pa përmendur shtimin e elementëve të islamofobisë dhe të laicizmit selektiv, që krijojnë precedentë të urrejtjes ndërfaqetare, falë edhe papërgjegjshmërisë së shumëkujt, që përpiqet në një formë a një tjetër kundër vlerave kombëtare dhe atyre fetare në vendin tonë.

Myftiu e informoi Raportuesin e OKB-së edhe mbi zhvillimin e arsimit fetar në Shkodër, duke nisur nga kurset fetare të xhamive, medresenë dhe aktivitetet e larmishme, që kanë për qëllim rritjen e nivelit të besimit tek masat e gjera, sidomos tek moshat e reja.

Pasditën e diel, më 15 maj 2017, erdhi për vizitë në Myftininë e Shkodrës një delegacion i OSBE-së i kryesuar nga Zv. Presidenti i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, z. Roberto Battelli.

Gjatë takimi, teologu Arben Halluni, pasi uroi mirëseardhjen e miqve, bëri një prezantim të aktivitetit të Myftinisë Shkodër, sikurse theksoi angazhimet e vazhdueshme në punën për mbjelljen e mësimeve dhe udhëzimeve të fesë islame në shoqëri, si një balsam shërues për problemet e shumta të shfaqura e të përhapura gjithandej.

Nga ana e tij, z. Battelli falënderoi Myftininë e Shkodrës për mikpritjen si dhe për mesazhet e paqes dhe harmonisë që përcjell në momente të ndryshme, duke dëshmuar vullnetin e ndërtimit të urave të komunikimit në mesin e popujve dhe shoqërive.

Përfaqësuesit e OSBE-së theksuan se vlerat e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfaqetare në Shkodër e Shqipëri, janë modele që merren përherë si një shembull pozitiv për krejt vendet e Evropës.

MYFTIU PRITI RAPORTUESIN E POSAÇËM PËR LIRINË E FESË DHE BESIMIT PRANË OKB



Myftiu theksoi se për më shumë se 500 vjet, shqiptarët kanë përqafuar në masë fenë islame, pa dhunë e shpatë, siç theksojnë librat e historisë komuniste, sikurse tha se e sotmja e Shqipërisë përpëlitet mes paradokseve të mëdha, si ai i përqindjes së lartë islame dhe aktualitetit të mbushur me shumë prej veseve dhe fenomeneve që Islami i ndalon dhe i lufton.

Raportuesi e pyeti Myftiun edhe mbi predikimet e ditës së xhuma në xhamitë

e Shkodrës. Me këtë rast, Myftiu tha se fokusi i hytbeve të xhumasë përqendrohet tek besimi, morali, vetëdijesimi i muslimanëve për madhësinë e fesë, sikurse jepen edhe mesazhe që lidhen drejtpërsëdrejti me ruajtjen dhe forcimin e paqes sociale, harmoninë komunitare, distancimin nga çdo tendencë që shpie drejt ekstremizmit dhe dhunës etj.

Ata diskutuan edhe për shumë çështje të tjera me dobi dhe interes.

ZV. PRESIDENTI I ASAMBLESË PARLAMENTARE TË OSBE VIZITË NË MYFTININË E SHKODRËS



Gjithashtu në këtë takim u diskutua edhe rreth nevojës së zhvillimit të takimeve dhe konferencave me pjesëmarrjen e institucioneve fetare dhe civile me qëllim trajtimin e tematikave

që kanë të bëjnë me rolin e komuniteteve fetare në promovimin e vazhdueshëm të paqes sociale, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të mëtejshëm në të gjitha sferat e jetës.



1 RAMAZAN	SYFYRI 3:08 IFTARI 20:12	27 MAJ	11 RAMAZAN	SYFYRI 2:59 IFTARI 20:19	06 QERSHOR	21 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:25	16 QERSHOR
2 RAMAZAN	SYFYRI 3:07 IFTARI 20:13	28 MAJ	12 RAMAZAN	SYFYRI 2:58 IFTARI 20:20	07 QERSHOR	22 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:25	17 QERSHOR
3 RAMAZAN	SYFYRI 3:06 IFTARI 20:13	29 MAJ	13 RAMAZAN	SYFYRI 2:58 IFTARI 20:21	08 QERSHOR	23 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:25	18 QERSHOR
4 RAMAZAN	SYFYRI 3:05 IFTARI 20:14	30 MAJ	14 RAMAZAN	SYFYRI 2:57 IFTARI 20:21	09 QERSHOR	24 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:26	19 QERSHOR
5 RAMAZAN	SYFYRI 3:04 IFTARI 20:15	31 MAJ	15 RAMAZAN	SYFYRI 2:57 IFTARI 20:22	10 QERSHOR	25 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:26	20 QERSHOR
6 RAMAZAN	SYFYRI 3:03 IFTARI 20:16	01 QERSHOR	16 RAMAZAN	SYFYRI 2:56 IFTARI 20:22	11 QERSHOR	26 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:26	21 QERSHOR
7 RAMAZAN	SYFYRI 3:02 IFTARI 20:16	02 QERSHOR	17 RAMAZAN	SYFYRI 2:56 IFTARI 20:23	12 QERSHOR	27 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:26	22 QERSHOR
8 RAMAZAN	SYFYRI 3:01 IFTARI 20:17	03 QERSHOR	18 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:23	13 QERSHOR	28 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:26	23 QERSHOR
9 RAMAZAN	SYFYRI 3:00 IFTARI 20:18	04 QERSHOR	19 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:24	14 QERSHOR	29 RAMAZAN	SYFYRI 2:56 IFTARI 20:27	24 QERSHOR
10 RAMAZAN	SYFYRI 3:00 IFTARI 20:19	05 QERSHOR	20 RAMAZAN	SYFYRI 2:55 IFTARI 20:24	15 QERSHOR	1 SHEVAL	FITËR BAJRAMI	25 QERSHOR

Falja e Sabahut bëhet 30 minuta pas Imsakut (Syfrit)
Oraret i janë referuar zonës së Shkodrës

21 Qershor 2017 (e mërkurë) - Nata e Kadrit
Namazi i Bajramit falet në 06:00



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org